



## Kodi i Etikës për Fushatat Dixhitale në Shqipëri

Ky Kod Etike për Fushatat Dixhitale (Kodi) është përgatitur nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (International IDEA), Instituti Demokratik Amerikan (NDI) dhe Qendra për Sundimin e Ligjit pranë Universitetit të Helsinkit, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Shqipërisë.. Kodi vjen edhe si produkt i një konsultimi të gjerë me partitë politike dhe shoqërinë civile. Kodi i Etikës mbështetet te prirja në rritje për vetërregullim dhe fryshtohet kryesisht nga Kodi i Etikës së Holandës për Transparencën e Reklamave Politike Online, miratuar në vitin 2021<sup>1</sup> dhe nga Kodi i Etikës për zgjedhjet e Parlamentit Evropian të vitit 2024<sup>2</sup>.

### 1. Hyrje

Përmes këtij Kodi Etike, subjektet zgjedhore angazhohen për ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025, si dhe të zgjedhjeve të tjera në të ardhmen.

Duke vepruar në përmbushje të këtij Kodi, nënshkruesit mbështesin parimet themelore të zgjedhjeve demokratike, si integriteti, transparenca, privatësia, siguria, drejtësia dhe kushtet e barabarta të lojës.

Ata janë të vetëdijshëm për rolin jetësor të partive politike në mbrojtjen e këtyre vlerave.

Transparenca i fuqizon qytetarët në marrjen e vendimeve të mirinformuara dhe të bazuara në informacione të besueshme. Dezinformimi dhe përmbajtjet e manipuluara përbëjnë një kërcënim për zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Nënshkruesit marrin përsipër të zbatojnë parimet e vërtetësisë dhe saktësisë në strategjitet e tyre të komunikimit dhe të luftojnë kundër keqinformimit dhe dezinformimit gjatë zgjedhjeve.

Nënshkruesit angazhohen për të parandaluar manipulin e qëllimshëm të publikut përmes përdorimit të gabuar të inteligjencës artificiale, për të forcuar integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, si dhe për të rritur besimin te demokracia.

<sup>1</sup> International IDEA and the Netherlands Ministry of the Interior and Kingdom Relations, <https://www.idea.int/news-media/news/first-national-code-conduct-online-political-advertising-european-union-signed-dutch>

<sup>2</sup> International IDEA and the European Commission, Code of Conduct for the 2024 European Parliament Elections, <https://www.idea.int/european-code-of-conduct-2024>



**RULE OF LAW  
CENTRE** | UNIVERSITY  
OF HELSINKI



Zotimet e ndërmarra në këtë Kod ndihmojnë për garantimin e mbrojtjes së zgjedhjeve nga manipulimet dhe ndërhyrjet e parregullta, duke vendosur disa standarde minimale për zhvillimin e fushatave në mënyrë etike, duke rritur aksesin e publikut në informacionet që kanë të bëjnë me fushatat, si dhe duke përmirësuar masat e sigurisë kibernetike dhe higjenës dixhitale në të gjithë mekanizmat e brendshëm të partive.

Ky Kod Etike mbulon aspekte të ndryshme të fushatave zgjedhore që kanë të bëjnë me aktivitetet dixhitale, si dhe me përbajtje dhe komunikime me dhe pa pagesë.

Partitë inkurajohen që të promovojnë brendaperbrenda tyre respektimin e këtij Kodi dhe që t'i nxisin anëtarët e tyre që të veprojnë në përputhje me angazhimet e marra përsipër gjatë fushatave të tyre zgjedhore.

Kodi do të bëhet publik për të ndihmuar gjerësisht median, studiuesit, zgjedhësit dhe qytetarët për të monitoruar se sa do të përbushen në praktikë angazhimet e ndërmarra. Kodi është i hapur për nënshkrim nga subjektet zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 dhe në vazhdim

## 2. Kuadri ligjor

Ky Kod Etike nënshkruhet mbi baza vullnetare dhe nuk ka për qëllim të zëvendësojë ligje ekzistuese apo ligje që mund të miratohen ne të ardhmen dhe as të ndërhyjë në respektimin e këtyre ligjeve nga nënshkruesit apo palët e tjera të interesit.

Megjithatë, ai është pjesë e një kuadri më të gjerë politikash në nivele të ndryshme qeverisjeje dhe ka për qëllim të jetë plotësues në raport me to. Ky Kod duhet të lexohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse në vend, si dhe me normat, konventat dhe ligjet ndërkombëtare ku aderon Shqipëria, sidomos me legjislacionin që vjen nga Bashkimi Evropian, me të cilin Shqipëria duhet të përafrohet.

Kodi mbështetet në dokumente të ndryshme ligjore dhe politike.

Ndër më të rëndësishmet janë:

- Neni 4, 9, 16/1, 18 dhe 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parimi i shtetit të së drejtës, e drejta për të votuar, barazia përpëra ligjit, transparenca financiare, ndalimi i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese, dhe integriteti i funksionarëve publikë.
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 10019, i vitit 2008, i ndryshuar)
- Ligji për partitë politike (Ligji nr. 8580, i vitit 2000, i ndryshuar)
- Ligji për mbrojtjen e të dhënavë personale (Ligji nr. 9887, i vitit 2008, i ndryshuar)



- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (Ligji nr. 10 221, i vitit 2010)
- Ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr. 97/2013)
- Ligji për sigurinë kibernetike (Ligji nr. 25/2024)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i ngarkuar me mbikëqyrjen e zgjedhjeve, ka rol vendimtar në monitorimin e reklamave politike, duke përfshirë edhe reklamat online, në kuadrin e garantimit të integritetit të zgjedhjeve.

### 3. Zotimet e palëve nënshkruese

Nënshkruesit e këtij Kodi Etike që përfaqësojnë subjektet zgjedhore që planifikojnë të regjistrohen në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 marrin përsipër bashkërisht sa vijon:

1. Të ruajnë integritetin e zgjedhjeve përmes respektimit të rregullave dhe normave në fuqi dhe përmes zbatimit të parimeve përfshirë fushata të ndershme dhe transparencë financiare.
2. Të nxisin një diskurs politik gjithëpërfshirës, pjesëmarrje dhe kontribut në procese zgjedhore të sigurta, veçanërisht:
  - a. duke mos prodhuar, duke mos përdorur ose duke mos shpërndarë deklarata dhe paragjykime diskriminuese ndaj grupeve të caktuara përfshirë gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë, besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual;
  - b. duke mos shpërndarë, duke mos postuar dhe duke mos promovuar mesazhe që nxisin dhunë ose urejtje; nënshkruesit inkurajohen të dënojnë me forcë dhe të ndërmarrin sanksione ndaj çdo akti dhune ndaj kandidatëve ose përfaqësuesve të zgjedhur.
  - c. duke mos shkuruar zgjedhësit dhe duke mos shpërndarë informacione të pasakta në lidhje me procesin zgjedhor, siç janë të dhënat e zgjedhësve, procesi i votimit dhe qendrat e votimit.
3. Të garantojnë një përdorim etik dhe transparent të mjeteve dhe teknologjive përfshirë edhe inteligjencën artificiale. Të mos prodrojnë, të mos shpérndajnë përbajtje keqinformuese, veçanërisht:
  - a. të dhëna ose materiale të rrreme, të fabrikuara, të bëra publike pa leje dhe në mënyrë dashakeqe ose të vjedhura;
  - b. përbajtje manipuluese, duke përfshirë përbajtje audio, imazhe ose video të gjeneruara me ose pa përdorimin e inteligjencës artificiale, me qëllim paraqitjen e shtrembëruar ose të falsifikuar në mënyrë të rrreme ose manipuluese të kandidatëve, zyrtarëve ose çdo pale tjetër të përfshirë në zgjedhje. Përdorimi i përbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale të bëhet vetëm kur kjo



përbajtje etiketohet qartësishët si e tillë. Në këto raste këshillohet përdorimi i shenjave dalluese (*watermarking*) dhe i shenjave që tregojnë origjinën e materialit (*provenance signals*);

c. llogari të rrëme ose *bot*-e automatike për të manipuluar opinionet e zgjedhësve;

d. trolle, akuza të pabaza ose bullizëm kibernetik;

e. përbajtje të krijuara dhe të shpërndara nga aktorë jashtë vendit që përpilen të dëmtojnë parimet e demokracisë, lirisë, barazisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe të promovimit të paqes e stabilitetit.

4. Të shfrytëzojnë të gjitha burimet e mundshme për të luftuar efektet negative të përbajtjeve manipuluese të gjeneruara nga inteligjenca artificiale dhe të shohin mundësitë e trajnimit të stafit të tyre për këtë qëllim; të mos përdorin informacione personale ose konfidenciale në instrumentet e inteligjencës artificiale, si për shembull në pyetjet apo udhëzimet e dhëna (*prompts*), duke garantuar kështu privatësinë dhe sigurinë e individit gjatë zgjedhjeve; të shohin mundësinë e ngritjes së një mekanizmi të strukturuar që do t'u mundësonë qytetarëve të raportojnë për shqetësime ose për keqpërdorim të teknologjive të inteligjencës artificiale.

5. Të garantojnë transparencën e kontributeve financiare të marra, duke përfshirë edhe përfitimet në natyrë si dhuratat, trajtimet, huatë, donacionet, kontributet për fushata dhe shpenzime, në përputhje me legjislacionin evropian dhe atë kombëtar në fuqi.

6. Të garantojnë transparencën e reklamave politike dhe komunikimeve të fushatës:

a. të mos përdorin reklama politike të sponsorizuara nga interesa të padekluarë dhe të mos angazhojnë palë të treta ndërmjetëse për dhënie mesazhesh për fushatë ku nuk identifikohet burimi ose sponsorizuesi i mesazhit.

b. të veprojnë në përputhje me politikat dhe mekanizmat e transparencës së platformave online dhe të jepin informacione të sakta mbi proceset e regjistrimit dhe verifikimit.

c. të ofrojnë informacion, mundësishët në faqet e internetit të partive politike në lidhje me:

i. organizatat dhe fondacionet me të cilat janë të lidhura; ose ne lidhje me subjekte të tjera ligjore që zhvillojnë fushatë në emër të tyre;

ii. përdorimin e reklamave politike, duke përfshirë sponsorizuesit, burimet e financimit dhe shumat e shpenzuara për to;

iii. targetimin e reklamave dhe përdorimin e çfarëdolloj sistemi të inteligjencës artificiale në shpërndarjen e reklamave.



d. të mos përdorin taktika, teknika dhe procedura manipuluese për amplifikim të mesazheve politike dhe të mos përdorin të dhëna sensitive për mikrotargetim. Të marrin masa që të dhënët e përdorura për fushata politike të jenë plotësish në përputhje me ligjin shqiptar për mbrojtjen e të dhënavëve, duke i kushtuar rëndësi të veçantë minimizimit të të dhënavëve dhe përpunimit të tyre në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente.

7. Të shmangin në mënyrë proaktive amplifikimin e narrativave që kanë për qëllim minimin e parimeve demokratike, të nxitura nga subjekte dhe aktorë si brenda dhe jashtë vendit.

8. Të ndërmarrin hapa aktivë për arritjen e standardeve bazë të sigurisë kibernetike, për të dalluar, parandaluar dhe frenuar sulmet kibernetike, si dhe për të shpërndarë informacion, duke përfshirë edhe përmes organizimit të trajnimeve brendapërbrenda mbi irrijet ndaj sigurisë kibernetike në zgjedhje.

9. Të heqin ose të kërkojnë heqjen pa vonesë të çdo përmbajtjeje të publikuar në emër të një pale që ka nënshkruar këtë Kod, nëse ajo përmbajtje është në shkelje të angazhimeve të këtij Kodi Etike. Përmbajtje të tilla duhet të raportohen në platformat online.

10. Të rrisin ndërgjegjësimin brendapërbrenda strukturave dhe organizatave të tyre për këtë Kod Etike dhe të nxisin zbatimin e tij nga stafi i fushatës, degët e partive, organet e tjera dhe institucionet që lidhen me to. Të inkurajojnë anëtarët që ta nënshkruajnë këtë Kod ose të respektojnë angazhimet e parashikuara në të.

11. Të marrin masa që stafet e tyre të fushatës dhe degët e partive të tyre të respektojnë me rigorozitet rregullimet kombëtare për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve publike gjatë zgjedhjeve; të rrisin ndërgjegjësimin e anëtarëve të partive për nevojën e respektimit rigoroz të këtyre rregullimeve.

12. Të promovojnë përmbushjen në mënyrë të pavarur të angazhimeve të parashikuara në këtë Kod Etike dhe bashkëpunimin e plotë me autoritetet mbikëqyrëse, vëzhguesit zgjedhorë ndërkombëtarë dhe vendas, si dhe me aktorë të tjerë të përfshirë në vëzhgimin e pavarur, si mediat, studiuesit akademikë dhe organizatat e shoqërisë civile.

13. Të diskutojnë për zbatimin e këtij Kodi Etike me kryetarët e subjekteve zgjedhore dhe/ose sekretarët e përgjithshëm dhe degët përkatëse të partive para zhvillimit të zgjedhjeve.

14. Të bëjnë një vlerësim pas zgjedhor dhe të vazhdojnë diskutimet brendapërbrenda subjekteve zgjedhore dhe mes subjekteve të ndryshme zgjedhore pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025.



International IDEA

RULE OF LAW  
CENTRE | UNIVERSITY  
OF HELSINKI

NDI  
NATIONAL  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE

LEVIZJA BASHKE - VITORI SIP

Vjosa

Partia Nëse Thirgj - Endrit Lleshi

Partia Maale's. Endrit Lleshi

Partia e Linise Ensa Xhixho

Partia Demokratike Alba Vokshi

PARTIA SOCIALISTË TONI GORGU

SHQIPERIA BEHET Dervish Pashli  
(PDIU) Shkelqim Sullo



**RULE OF LAW  
CENTRE** | UNIVERSITY  
OF HELSINKI



Aleancë Komisione Shqiptare → Elene Kocipi



**RULE OF LAW  
CENTRE** | UNIVERSITY  
OF HELSINKI

